




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2026, mbajtur më 7.8.2025, i cili filloi në orën 14:00.

Të pranishëm ishin: Bekim Gashi- drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Valbona Makolli- drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Arbër Gashi nga Drejtoria e Arsimit.

Në diskutim morën pjesë qytetarët: Betim Sylejmani, Supije Zhitija, Dren Shahini, Bashkim Sllamniku, Hysen Bublica, Osman Dragusha, Gani Dobratiqi, Isa Rexha, Bislim Sylaj, Musli Gashi, Nazif Gashi, Feim Osmani.

Diskusimin me qytetarë e kryesoi **Osman Bllaca**.

Osman Bllaca: - siç e dini rutinën tonë këtë javë e kemi filluar me mbajtjen e planifikuar të buxhetit 2026. Sot mbahet me kryetarët e bashkësive lokale, lagjeve, fshatrave të Komunës së Prishtinës, qytetarë dhe disa drejtorë të shkollave.

Isa Rexha: kryetari i këshillit lokal Barilevë - ai tha se për Drejtorinë e Investimeve Kapitale kemi 8 kërkesa:

1. Problemin më të madh e kemi të lagjja “Kurtolli” asnjëherë s’ka pas ujë, e kemi punuar projektin në ujësjellës 77 mijë euro është caktuar vlera;
2. Barilevë gjithsej 32 km të pashtuar, pa rregulluar, ka rrugë që s’ka asnjë pjesë zhavorr;
3. Barileva i ka 3840 m kanalizim, gjysma e më tepër s’kanë kanalizim;
4. Kërkesa për pengesa në rrugë;
5. Rregullimi i një parkingu të hapësirës të varrezat në Barilevë, komuna i ka nda nga 1 hektar e gjysmë, apo 15.000 m;
6. Kërkesa për një muri mbrojtës në lagjen “Verbovci, Brestovci”;
7. Për zgjerimin e urës të lagjja “Leci”;
8. Kërkesa për ndriçim;
9. Thurja e hapësirës që është e caktuar për varreza 15.000 m;
10. Për caktimin e lokacionit të stacionit të autobusëve;
11. Pastrimi i lumit “Llap”;
12. Për stadiumin kërkesë për kadastrë, gjeodezi dhe Drejtorinë e Pronës, në asamble komunale ka arrit me peticion të hyjë në diskutim dhe është votuar para 3-4 muajve, pse nuk është ndarë ajo;
13. Të parqet, kërkesën për vendosjen e ulseve;
14. Kërkesë, peticion për lagjen “Xhafolli” që të shkojë autobusi, kurse të “Verbovci” dhe “Brestovci” të paktën një kombi me 5-6 herë me pas linjë në ditë.

Osman Dragusha, kryetar i këshillit lokal Prugoc: - ai tha që kisha vazhduar me paraqitjen e kërkesave që i ka paraqit edhe me herët.

1. Te lagjja e parë ka qenë e planifikuar një trotuar, për arsye të ngarkesës së frekuentimit sidomos pasdites, rruga Prishtinë - Podujevë ku rreziku është i vazhdueshëm.
2. Është një sipërfaqe 6 hektarë, është pronë e komunës ku të gjithë kryetarëve që nga paslufta ju kemi kërkuar që të investojnë se mund të bëhet një qendër rekreative, jashtëzakonisht e mirë, ku dikur ka qenë epiqendër e Komunës së Prishtinës për kalimin e vikendeve si lloj pikniku, kurse sot është deponia më e madhe për mbeturina në Komunën e Prishtinës, si dhe materialin e punimeve e sjellin e zbresin gjatë natës dhe vazhdimisht bëjnë shkarkime, në ç'rast rrezikohet edhe ambienti edhe jeta e banorëve që jetojnë aty.
3. Te lagjja e dytë ka më shumë nevojë për intervenim në infrastrukturë rrugore, sepse është bërë një lagje e mirë me 2 fusha sportive, me një ndriçim, kënd të fëmijëve.
4. Lagjja e 3 s'kemi ndonjë kërkesë shumica e nevojave që i kanë pas janë plotësuar.
5. Lagjja 4 kemi një pjesë mungesë të ndriçimit, ku diku 80-90 % është realizuar, po fatkeqësisht ka mbetur edhe pak disa që po presim të përfundojnë. Në shkollën në Prugoc ku unë gravitoj dhe punoj rastësisht kam qenë aty ku disa të rinj duke lozur e kanë shpëtuar një fëmijë duke i ra me fytyrë rrethojës së shkollës që është dëmtuar aq shumë. Është aq rrezik për ata fëmijë nga klasa 5 deri te e 9-ta përfshirë 160 nxënës. Neve na mungojnë edhe sallat e leximit, kabinetet edhe salla e edukatës fizike ku kemi pas premtime se do ketë investime në atë aspekt dhe nuk ka ndodh dhe një kërkesë që e kam bërë të vazhdueshme, janë disa pengesa jo me lartësi të mëdha po me shiritat e bardhë për ngadalësim për shkak të shpejtësisë së madhe në atë pjesë ku kisha kërkuar me urgjencë të ndërmerri për shkak të fëmijëve ku i kryejnë shërbimet në anën tjetër të rrugës.
6. Stacion të autobusëve në lagjen e 3 s'ka në as njërin anë. Edona vazhdimisht qarkullon po janë në mungesë ku udhëtarët që dalin janë të rrezikuar, për shkak që vetëvendosja e autobusit bëhet në rrugë kryesore.
7. Të lagjja e 5 është kryer një pjesë e infrastrukturës vetëm për rrugë s'kanë ndonjë veçanti. Dhe harrova të cek në lagjen 1-2-3 janë në tërësi edhe 13 rrugica të cilat kanë nevojë për intervenim sepse janë të pashtuara as me zhavor e as me ndonjë material tjetër, as asfalt ose kubëza që po shtrohen.

Dren Shahini - kryetar i këshillit Mati 1 Jug: - ai paraqiti pakënaqësi për orarin e ndërrimit të dëgjimit publik me qytetarë, pat filluar me 6-mujorin e parë të zellshëm të kryetarit me dal pasdite orari ku njerëzit mund të marrin pjesë më lehtë, kur filluan me u lodh nga viti 2-3 i qeverisjes filluan me dal ka ora 10 se atëherë duhet me u përfunduar gjithqysh gjatë orarit të punës, e dëgjoj çka e dëgjoj, u shkruar qfarë u shkruar dhe tash ka fundi i mandatit del ka ora 2 pasdite ku kryhen këto e dalim pak më herët domethanë kjo e tregon krejt këtë Prishtinën tonë qysh e qeverisim ne bashkë jo veç komunarët, ata që e kanë marr përgjegjësinë po edhe ne si qytetarë. Po megjithatë përgjegjësinë e ka kryetari se ne votojmë për kryetar e jo për drejtorë. Unë i kam thënë disa herë, drejtorët janë të përzgjedhurit e tij ata përgjigjen po mungesa e tij sidomos kur buxhetohet buxheti i kryeqytetit flet shumë. Me paraqit këtu një lagje që nuk ka problem që nuk ka arrit deri të krejt drejtorët bashkë me kryetarin s'ka problem brenda lagjes, po për secilin problem rreth 3-4 herë kanë qenë në lagje dhe i kanë vizituar, i kanë prek edhe vetë, qoftë nënkryetar, drejtor, 2 herë kryetari. Janë të njëjtat probleme, prapë s'po ndërron asgjë vazhdimi i rrugës pjesa e dytë "Muharrem Fejza", rrugë e lënë në gjysmë, na është premtuar nga drejtori i infrastrukturës do të përfundohet do buxhetohet, erdhën të

rinjtë prapë njësoj gjendja, madje përveç që s'po buxhetohet me u kry si pjesë e 2 rikonstruktimi total as s'po mbulohet me një shtresë të asfaltit se gropat janë bë shumë të mëdha, s'ka as trotuar, është pjesa e dytë e parikonstruktuar "Muharrem Fejza". Ne e shohim asfaltin çdo ditë duke u shtruar nëpër storie të drejtorit nëpër shtëpi, lagje as 200 shtëpi nuk janë. Secila rrugicë është pa ndriçim, pa ndriçim publik, nxënësit s'kanë trotuare, s'kanë shenjëzim rrugët ku është lagjja me dendësinë më të madhe dhe më e populluar. Tash erdha me autobusin që e frekuenton lagjen tonë dhe kushtet janë mizërie. Kaloj ky 6 muaj ku kanë pas me e bë reformën përbrenda po askush s'po i trajton, vetëm kur po bëhet diçka shumë e madhe atëherë reagojnë. Janë gropa që i kanë lënë ujësjellësi, që qytetarët nuk e dinë që është e ndërmarrjes të nivelit qendror, jo ndërmarrje e nivelit komunal, ka edhe këso probleme që e pësojnë qytetarët. Është problem madhor çerdhja publike. Jemi duke i prit pikat e reja të kontejnerëve, pastërtia është, kërkohet që drejtori Izet të jetë i pranishëm, minjtë kanë arrit madhësinë e maceve që nuk trajtohet vetëm 2 herë një lagje me deratizim, ku dendësia e popullatës i kanë sjell mbeturinat dhe mbeturinat minjtë. Shenjëzimin, ndriçimin, kontejnerët shtesë, ka filluar pastërtia pas reagimit tënd, gjelbërimi është shumë i nevojshëm, kamera, siguria dhe gjithçka çfarë i nevojitet një lagjeje të re rruga "Muharrem Fejza" me rrugë lidhëse ka nevojë. Për fund ishte shumë shqetësuese me i pa hekurat këtu në hapësirë gjelbëruese prapa komunës veçanërisht në derë të komunës nëse ajo ndodh i priftë e mbara secilit në zgjedhje dhe suksese tash.

Gëzim Syla - kryetar i këshillit lokal Besi: - ai pati disa kërkesa:

1. fshati Tenezhdoll ku ndriçimi është i dëmtuar pjesërisht dhe një pjesë e rrugës është dëmtuar.
2. Kërkesë nga lagjja "Serovci" me u lidh me Tenezhdollin.
3. Kërkesa vjen prej Vranidollit lagjja "Abdullahi" rruga ku kalon linja urbane ka nevojë për intervenim shumë të shpejt, kanalizimi i dëmtuar, ndriçimi.
4. Kërkesë për fshatin Besi, disa rrugica të papërfunduara afër 15, shtylla nëpër tokë ndriçimi publik, lagjja "Bllaca" po ashtu edhe ai problem ish evident, disa rrugë p.sh. Lebanë, lagjja "Bllaca" ka nevojë me u lidh, megjithatë ka filluar me punuar aty diçka.
5. Fshati Rimanishtë, rruga Siçevë - Rimanishtë afër 3 vite e asgjë s'kanë ndërmarr. Kanalizimi është i papërfunduar në Rimanishtë, edhe aty ku ka përfundua e kanë lënë një pronë private që është fatkeqësi e madhe mes Rimanishtës dhe Besisë, ndriçimi pak është punuar, çfarë është me kryesorja ujësjellës nuk ka fshati Rimanishtë që nga viti 2013, me kërkesa të vazhdueshme.
6. Për drejtorin e shëndetësisë disa kërkesa rreth kulmit të qendrës familjare Besi, kati i 2 vetëm është në deformim e sipër.

Supije Zhitija - drejtoreshë në Shkollën "Gjergj Fishta": - ajo paraqiti disa kërkesa: rregullimin e oborrit të shkollës me shumë me u nda një pjesë e buxhetit dhe kulmeve të shkollës përfshirë posaçërisht ollukt edhe çështja e nyja sanitare është serioze, fola specifikisht për shkollën time. Me sallën e edukatës fizike po qëndrojmë mirë, e falënderoj edhe DKA-në, edhe Komunën e Prishtinës sepse goxha kapital është bë, po në përfundim të oborrit pikërisht për këtë çështje dashta që oborri me u finalizuar një pjesë që shkolla të paktën të përfundojë dhe të paktën një parking simbolik s'kemi mundësi me pas një parking vetanak.

Osman Dragusha: - ai ka një kërkesë, një takim sa më të shpejtë me kryetarin. Ka drejtorë që 2 vite s'kam pas fatin me taku asnjëherë për shqetësimet që i kemi.

Nazif Jashari - drejtor i Shkollës "Asim Vokshi": - ai të gjitha kërkesat i ka adresuar rreth shkollës dhe rreth shollës të Arbërisë. Kërkesa e tij është rruga për Podujevë, para shkollës

është një objekt ka mbet shumë i shëmtuar ose gërmadhë me sa di është privatizuar. Ne këtë vit do kalojmë me mësim 6-9, do vjen shkolla “Zenel Hajdini”, aty ka njerëz që frekuentojnë, ne me policinë i kemi raportet e mira dhe i kemi informuar për çdo gjë, por tash është një brengë shumë më e madhe se kemi punuar vetëm paradite, tash mësim do kemi dhe pasdite, aty mund të bjen dikush në atë objekt që ka mbet shumë gërmadhë edhe shkollën po e shëmtton.

Musli Gashi - drejtor i Shkollës “Avni Rrustemi” Mramor: - ai tha se shumicën e kërkesave veçse i kemi adresuar ne në Drejtorinë e Arsimit, ne gjatë ditës së djeshme ishim me Arbërin për problemet e infrastrukturës nëpër shkolla dhe s’kam diçka çfarë me shtuar atje diçka. Sa i përket qytetarëve dhe ndriçimit në fshatin Mramor ka mangësi, mendoj që kërkesat janë të adresuara prej kryetarit në bashkësi lokale që e kemi atje. Kam qenë edhe vetë pjesë e atyre kërkesave për disa ndriçim, disa ura, nënkalime për nevojat e fshatit. Ndriçimi në oborrin e shkollës është i dobët, vetëm 2 drita funksionojnë, një kërkesë jashtë asaj që kemi diskutuar me zyrtarin Arsimin.

Isa Rexha- kryetar i bashkësisë lokale Barilevë: - bisedon pa mikrofon nuk kuptohet asgjë.

Dren Shahini - kryetar i këshillit lokal Mati 1 Jug: - kërkesën për të shkolla “Pavarësia” e dinë krejt për punën e fushës dhe gjithçka, çfarë kisha dashtë me ju lut me e bë një buxhetim për ujë të pijshëm jo gjatë tërë kohës po kur e kemi problemin me manganin, ne furnizohemi prej Badocit dhe shkolla mbetet, duhet prindërit me sakrifikuar prej asaj parasë që ia japin fëmijëve për shkollë me nda edhe për ujin e pijes një pjesë se sa vite po ndodh shkolla nuk është furnizuar me ujë të pijes, 1 shishe për secilin nxënës 2-3 paleta ujë çdo ditë nuk kishte me qenë aq e rëndë për buxhetin e komunës në këtë periudhë kur atakohemi prej manganit, kur nuk pihet ujë nga ujësjellësi. Të lutem nëse mundesh me i dhënë prioritet së është me rëndësi. Unë e kam konsideruar diskriminim procesin e mësimi tërëditor, është dashtë me fillu të gjithë, se dikush merr shujtë prej buxhetit të përgjithshëm e dikujt as ujë nuk i sigurohet.

Arbër Gashi - zyrtar nga Drejtoria e Arsimit:- kemi diskutuar me drejtorin Samir dhe do jemi në shkollën “Pavarësia” shumë shpejtë, është nënshkruar edhe kërkesë për dislokimin e saj e trafos ku do të dislokojmë trafon dhe do e shtrojmë terrenin sportiv, do të jetë aktiv edhe tereni sportiv. E kemi diskutuar edhe punën e ujit, me pa si mundemi me ofruar një zgjidhje derisa kalon gjendja e manganit. Pjesa e mësimi tërëditor jemi duke u zgjeruar gradualisht, me i përfshirë të gjitha shkollat është bukur problem, kurse pjesa e infrastrukturës ku shërbehet ushqimi, servohet ushqimi, qëndrim tërëditor, ju deri vonë e keni pas shkollën me 3 ndërrime me aneks kemi kaluar me 2 ndërrime, kur finalizohet puna e shkollës të “Rruga C” dhe Veternik ne mendojmë që do lirohet edhe “Ismail Qemajli” dhe “Pavarësia”, lirohet pak edhe “Hasan Prishtina” bie numri i nxënësve dhe krijohen kushtet ideale për me mbajt mësimin tërëditor, ose 2 shkolla që jeni afër njëra me kalu 1-5 dhe tjetra 6-9, me pas hapësira për aktivitete. Me numrin e tanishëm në shkollën “Pavarësia” është pak sfidë, nuk është e përealizueshme dhe besoj që gjatë zgjerimit të këtij projekti vitet e ardhshme do e bëjmë, por për momentin është sfidë e madhe.

Hysen Bublica - përfaqësues i lagjes “Qëndresa Home”:- tha se kam vetëm 3 kërkesa.

1. Shtrimi i rrugës “San Antori”, rregullimi i trotuarit, aty 3-4 lagje e frekuentojnë atë lagje.
2. Shtrimi i rrugës “Ilirida” është 450 km, problemi me këtë rrugë është se qëndron në pronësi të “Ibër Lepencit”.

3. Rregullimi i kanalizimit që ndodh shumë shpesh kur ka vërshime me pas dëme të mëdha humbje deri në 50 mijë euro.


Osman Bllaca: - paraqiti një kërkesë për renovimin e Shkollës “Sami Frashëri” për Arbërin

Arbëri - përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit: - renovimi i Shkollës “Sami Frashëri” sapo të aprovohet buxheti i vitit 2026 mundemi me e lidh kontratën dhe me fillu punimet. Pa u miratuar buxheti nuk mundemi, sepse buxheti aktual është i orientuar në renovimin e shkollës “Zenel Hajdini” dhe brenda 5 dite pritet edhe renovimi i 5 shkollave tjera për zgjerimin e mësimi tërëditor. Ne tani kishim mundur të fillojmë punimet se në kontratë është marrëveshja nga viti 2026 po meqenëse është i paaprovuar, një gjë e tillë nuk mundet. Është prioritet i DKA-së dhe asgjë s’ka ndryshuar rreth Shkollës “Sami Frashëri”.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit për vitin 2026,
7 Gusht, 2025
Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	Betim Sygymena	Sygymena	Drejtore	betim.sygymena@qnd	
2	Supise ZHITIZA		Drejtore	zshitisupise@qnd	
3	DESD STATHINI		Kryetar MAT 1-5		
4	Bashkëpunuesitë		qytetar - Cendreci		
5	HUSEN BOBLICA		ADMINISTRATOR		
6	OSMAN	DEAGUSTHA	KCL - Prapo	osman.osman@qnd	
7	SAVA	VERBUE	KCL - Prapo		
8	JSQ	VERBUE	KCL - Prapo		
9	PSH/IN	SYLA	K.L. BASHKËPUNUESITË		
10	QANI DO	DEBERTAI	K.L. - bashkëpunuesitë		

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!
Pjesëmarrësit janë të njohur se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	Musi	Gashi	Drejtor Shkollë	musli.gashi@qga	
12	Shaz	Gashi	Drejt	mozgashou@qga	
13					
14					
15					
16					
17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen! *

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature